



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. ____ / 2021

PËR

NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998,
“PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Neni 1

Pasqyra nr.1, “Tabela për tatimin mbi të ardhurat personale nga punësimi”, bashkëlidhur ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, zëvendësohet me pasqyrën nr.1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare” dhe i shtrin efektet duke filluar nga data 1 korrik 2022.

K R Y E T A R I

LINDITA NIKOLLA

Pasqyra nr.1

Tabela për tatimin mbi të ardhurat personale nga punësimi

| E ardhura nga paga në lekë/muaj | | E ardhura e tatueshme në lekë/muaj | | Norma tatimore në përqindje/mujore |
|---------------------------------|----------|------------------------------------|----------|--|
| Nga | Deri në | Nga | Deri në | |
| 0 | 40 000 | 0 | 40 000 | 0% |
| 40 001 | 50 000 | 0 | 30 000 | 0% |
| | | 30 001 | 50 000 | 50% * 13% të shumës mbi 30 000 lekë |
| 50 001 | Më tepër | 0 | 30 000 | 0% |
| | | 30 001 | 200 000 | 13% e shumës mbi 30 000 lekë |
| | | 200 001 | Më tepër | 22 100 lekë + 23% të shumës mbi 200 000 lekë |